



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

KD.nr.13 /2017

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët: Nenad Lazic, kryetar, Manushe Karaqi dhe Skender Çoçaj, anëtar të Komisionit, duke e shqyrtuar çështjen e përgjegjesisë disiplinore ndaj Xxxx xxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx-dega në xxxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor ZPD-2017-082, i njëjti në procedurë te Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/07/2017, për pretendimin për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, të Ligjit për Këshillin Gjyqësor te Kosovës dhe 1.4 shkelje e Kodit të Zbatueshme të Etikës sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223) si dhe shkelje e rendë 5.1.1 të Rregullores nr.04/2016 për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme, në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, z.Arianit Salihu dhe gjyqtarit xxx xxxxx me datë 30.08.2017 merr këtë:

V E N D I M

Xxxxx xxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx-Dega në xxxxx, **nuk** është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, dhe 1.4 shkelje e kodeve të zbatueshëm të etikës të përcaktuara sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), si dhe shkelje e rendë 5.1.1 të Rregullores nr.04/2016 për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme siç është pretenduar në raportin përfundimtar të Zyrës se Prokurorit Disiplinor ZPD-2017-100.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurorit Disiplinor i'a ka paraqitur Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin përfundimtar ZPD-2017-100 se bashku me shkresat e lëndës, më të cilin e ka ngarkuar xxxxx xxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjakovë-dega në xxxxx për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2- neglizhencë në kryerjen, dështim për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodit të zbatueshëm të etikës të përcaktuara sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovë si dhe shkelje e rendë e neni 5.1.1 të Rregullores nr.04/2016 për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme.

Zyra e prokurorit Disiplinor hetimin Disiplinor e ka filluar në bazë të një parashtrese te dërguar nga Zef Malësia ndaj xxxx xxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx-Dega në xxxxxme pretendimin se është vonuar në vendosjen e lëndës P.nr.9/16, gjegjësisht ndaj prapësimit të ushtruar nga debitori përmbarues ndaj urdhrit mbi lejimin e përmbarimit të lëshuar nga

përmbaruesi privat. Pas zhvillimit të hetimit ZPD pretendon se ka siguruar provat të mjaftueshme në bazë të të cilave ka mbështetur raportin duke kërkuar nga Komisioni Disiplinor inicimin e procedurës disiplinore.

Në seancën disiplinore të Komisionit të mbajtur me datë 30.08.2017, ZPD e ka mbështetur në tërësi raportin përfundimtar me numër ZPD-2017-100 dhe ka kërkuar nga Komisioni inicimin e procedurës disiplinore.

Hetimin disiplinor ZPD e kishte zhvilluar mbi bazën e neglizhencës në ushtrimin e funksionit gjyqësor nga ana e gjyqtarit të vendosjes sipas mjetit juridik të ushtruar nga debitori ndaj urdhrit mbi lejimin e përmbarimit të lëshuar nga përmbaruesit privat. Ajo për çka për ZPD-ën ka qenë e pa arsyeshme është fakti ka qenë fakti se gjyqtari xxxxxx ka vonuar për mbi një (1) vite vendosjen mbi prapësimin e ushtruar ndaj Urdhrit për lejimin e përmbarimit, përkundër që sipas plotësim ndryshimit të Ligjit për Procedurën Kontestimore Gjykata duhet të vendos për një afat prej 30 dite.

Gjyqtari xxxxx në seancën e Komisionit Disiplinor deklaroj se ai si gjyqtar është emëruar në vitin 2012 dhe se dy vitet e para ka qenë në Kundërvajtje, pra në dhjetor te vitit 2014 është caktuar si gjyqtar civilistë në të gjitha natyrat duke përfshirë edhe rastet e natyrës përmbarimore me një numër të madh të lëndëve, për veç lëndëve të natyrave kontestimore, jokontestimore, trashëgimore, familjare, statusore. Sipas Ligjit të Procedurës lëndët përmbarimore i kryen gjyqtari përmbarues, e që në këtë rast unë jam caktuar si gjyqtar civilist por i kam punuar edhe lëndët përmbarimore. Fillimisht e kundërshton raportin e ZPD-së për fakti se ka neglizhencë, kur dihet se te gjithë Gjykatat dhe gjyqtaret janë të ngarkuar me një numër të madh të lëndëve. Në rastin konkret gjyqtari xxxxx ka qenë i ngarkuar me 600 lëndë. Theksoj se e kundërshtoj raportin e ZPD-së sepse nuk ka neglizhencë për faktin që as kreditori nuk ka parashtruar ndonjë urgjencë sikurse edhe në rastet kur palët parashtrojnë. Sikur të kishte pasur urgjencë e ta kisha neglizhuar urgjencën e tij atëherë do të pajtohesha me raportin e ZPD-së. Si gjyqtar civilist ka qenë i ngarkuar me lëndë civilë, kontestimore, jokontestimore, familjare, urdhër mbrojtje nga dhuna në familje, trashëgimore, përmbarimore. Lënda konkrete është vendosur para se kjo çështje, apo procedurë të hapet të ZPD-ja.

Në fjalën përfundimtare deklaroj se ZPD hetimin disiplinor e kishte filluar mbi bazën e neglizhencës të ushtrimit të funksionit gjyqësor nga ana e gjyqtarit të vendosjes sipas prapësimit të ushtruar nga debitori ndaj Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit të lëshuar nga përmbaruesi privat. Shqetësuese për ZPD-ën ka qenë vonës për vendosje për prapësim për 12 muaj e pesë ditë, përkundër që Ligji për Procedurën Kontestimore, konkretisht plotësim ndryshimi ka caktuar që gjyqtari duhet të vendos për 30 ditë. Sipas ZPD-së ata janë në dijeni për numrin e pa mjaftueshëm të gjyqtareve, numrit të madhtë lëndëve por që nuk është as faji i qytetareve me prit për me ju zgjidh problemi i tyre. ZPD e mbështet raportin përfundimtar dhe e konsideron si të tej kalueshme çdo arsyetim sa i përket vendosjes sipas prapësimit të ushtruar nga debitori ndaj

Urdhrit mbi lejimin e përmbarimin të lëshuar nga përmbaruesi privat, duke kërkuar nga Komisioni Disiplinor ta shpall përgjegjës gjyqtarin xxxx dhe të njëjtit ti shqiptoj sanksion disiplinor në përputhje me sjelljen e pahijshme të vërtetuar në këtë raport përfundimtar.

Gjyqtari xxxx deklaroj në fjalën përfundimtare se ka qenë i ngarkuar me një numër të madhtë lëndëve, kanë qenë vetëm dy gjyqtar që kanë punuar me lëndë civile të natyrave të ndryshme si kontestimore, jokontestimore, trashëgimore, statusore, të dhunës në familje edhe me përmbarimore. Sipas ligjit për procedurën përmbarimore lëndët përmbarimore i kryen gjyqtari përmbarues e në këtë rast unë jam gjyqtar për lëndët civile, prandaj pretendimi i ZPD-së mendoj se nuk është i rëndësishëm kur kihet parasysh fakti se si mundet një gjyqtar të merret me lëndë të natyrave të të gjitha çështjeve civile, kur dihet për numrin e madh të lëndëve të vjetra që ekzistojnë dhe kontesteve të natyrave të komplikuar, deklaroj gjyqtari gjatë seancës.

Gjithashtu pretendimi se Ligji i Procedurës Përmbarimore parasheh afatin ligjor, nuk qëndron sepse në nenin 72, nuk parashihet ndonjë afat decidiv dhe se edhe përkundër që është rregulluar përmes një mendimi juridik të Gjykatës Supreme dhe tani në 2017 me plotësimin e këtij ligji, do të isha pajtuar me të njëjtin sikurse të isha caktuar si gjyqtar përmbarues, vetëm i lëndëve përmbarimore. I kujtoj Komisionit që unë nuk është fajtor për numrin e vogël të gjyqtareve, ngarkesën e madhe me lëndë dhe ju propozoj që ta refuzoni raportin e ZPD-së. Në rast se mendoni se ka shkelje të tilla ta keni parasysh rrethanat që i paraqita gjatë seancës.

Komisioni Disiplinor i administroj të gjitha provave në shkresat e lëndës, ka dëgjuar edhe deklarata e gjyqtarit të dhënë gjatë seancës dëgjimore, dhe pasi i ka shqyrtuar dhe analizuar konstatoj se gjyqtari xxxx nuk është përgjegjës për pretendimet e ZPD-së dhe nuk ka neglizhuar në kryerjen dështim për të kryer apo abuzim të funksioneve gjyqësore, nuk ka shkelur kodin relevant të etikës për gjyqtar, dhe nenin 5.1.1 të Rregullores nr.04/2016 për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme me rastin e vendosjen sipas prapësimit të ushtruar nga debitori ndaj urdhrit mbi lejimin e përmbarimit të lëshuar nga përmbaruesit privat.

Gjyqtari xxxx në Gjykatën themelore në xxxx dega në xxxx ka qenë i caktuar gjyqtar për lëndë civile dhe ka punuar me lloje të natyrës si: kontestimore, jo kontestimore, familjare, statusore, dhune në familje, trashëgimore. Kanë qenë të caktuar vetëm dy gjyqtar për zgjidhjen e lëndëve civile dhe duke e marrë parasysh ngarkesën e madhe me lëndë prej të cilëve shumica kanë qenë lëndë të natyrave urgjente, po ashtu edhe pamundësi që një gjyqtar i vetëm të merret me lëndët përmbarimore, ka qenë gati e pamundur që rasti konkret të përfundohet në afat me të shkurtër. Rasti konkret nuk ka pasur pasoja për palët duke marrë parasysh që procedura përmbarimore ka mundur të vazhdojë nga përmbaruesi privat, përkundër paraqitjes së prapësimit. Gjithashtu kërkesa të Zyra e Prokurorit Disiplinor është paraqitur pasi që gjyqtari xxxxx e ka përfunduar lëndën dhe se kjo paraqitje është bërë nga pala e pakënaqur me vendimin.

Në rrethana të lartpërmendura, Komisioni konstaton se gjyqtari xxxx xxxx nuk ka kurrfarë përgjegjësie disiplinore siç ka pretenduar në raportin përfundimtar ZPD-ja ZPD-2017-100.

Duke patuar parasysh të gjitha këto, Komisioni vlerëson se në këtë rast gjyqtari xxxx nuk ka kryer sjellje të pahijshme siç pretendon ZPD dhe nuk është involvuar me ndonjë veprim konkret që do të rezultonte me shkelje të standardeve të sjelljeve profesionale për gjyqtarë.

Prandaj, nga këtu dhe nga arsyet e sipër theksuara, Komisioni ka konstatuar se gjyqtari xxxx xxxxx **nuk** është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të parapara me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika 1.2, dhe 1.4 të ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nuk ka shkelur standardet e Kodit e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar dhe nenin 5.1.1 të Rregullores 4/16 për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme. Në seancën për këshillim dhe votim, njëzëri vendosi që xxxx xxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx-xxx në xxxxx të lirohet nga përgjegjësia disiplinore, prandaj vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD.nr.13/2017, datë 20.07.2017

Kryetar i Komisionit Disiplinor
Gjyqtari, Nenad Lazic

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimi të Vendimit.

Vendimi t'u dërgohet:

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Zef Prendrecaj, drejtor, Zyra e Prokurorit Disiplinor;
- Xxx xxxx, kryetar në Gjykatën Themelore në xxxxx;
- Xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx-Dega në xxxx;
- Departamenti të Administratës dhe Personelit në SKGJK;